

Përmirësimet në SNRF-të

Amendime në SNRF 1 *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë*

Paragrafët 27 dhe 32 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është hequr një vizë). Janë shtuar paragrafi 27A, një titull dhe paragrafët 31B dhe 39E.

Paraqitja dhe dhënia e informacionit shpjegues

- 27 ~~SNK 8 nuk ka të bëjë zbatohet~~ për ndryshimet në politikat kontabël që ~~ndodhin kur~~ që një njësi ekonomike ~~ndërmerr kur~~ së pari adopton SNRF-të ~~ose për ndryshimet në ato politika deri sa ajo paraqet pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve~~. Prandaj, kërkesat e SNK 8 ~~për dhënien e informacioneve shpjeguese~~ në lidhje me ndryshimet në politikat kontabël nuk zbatohen në pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve të një njësie ekonomike.
- 27A Në qoftë se gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve një njësi ekonomike ndryshon politikat kontabël ose përdorimin e përjashtimeve të tyre të dhëna në këtë SNRF, ajo do të shpjegojë ndryshimet mes raportit të parë financiar të ndërmjetëm sipas SNRF-ve dhe pasqyrave të saj të para financiare sipas SNRF-ve, në përputhje me paragrafin 23, dhe do të përditësojë rakordimet e kërkuara nga paragrafi 24(a) dhe (b).

Përdorimi i kostos së supozuar për veprimtaritë që i nënshtrohen rregullimit të tarifës

- 31B Nëse një njësi ekonomike përdor përjashtimin në paragrafin D8B për veprimtaritë që u nënshtrohen rregullimit të tarifës, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe për bazën mbi të cilën ishin përcaktuar vlerat kontabël neto sipas PPPK –së të mëparshëm.

Raportet financiare të ndërmjetme

- 32 Në përputhje me paragrafin 23, në qoftë se një njësi ekonomike paraqet një raport financiar të ndërmjetëm në përputhje me SNK 34 për pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, njësia

ekonomike do të plotësojë përveç kërkesave të SNK 34 edhe kërkesat e mëposhtme,

- (a) Çdo raport financiar i ndërmjetëm, nëse njësi ekonomike ka paraqitur një raport të tillë financiar të ndërmjetëm për periudhën e krahasueshme menjëherë pas vitit financiar të mëparshëm, do të përfshijë:
- (i) një rakordim të kapitalit neto të saj në përputhje me PPPK-në e mëparshëm në fund të kësaj periudhe të përkohshme të krahasueshme me kapitalin neto sipas SNRF-ve në këtë datë; dhe
 - (ii) një rakordim të shumës të të ardhurave të gjithëpërfshirë të saj në përputhje me SNRF-të për atë periudhë të ndërmjetme të krahasueshme (që nga fillimi i vitit e deri në momentin aktual). Pika e fillimit për këtë rakordim do të jenë të ardhurat totale gjithëpërfshirë 5se në përputhje me PPPK-në e mëparshëm për atë periudhë, ose, në qoftë se një njësi ekonomike nuk ka një raport të tillë, fitimi ose humbja totale në përputhje me PPPK-në e mëparshëm.
- (b) Përveç rakordimeve të kërkuara nga (a), raporti i parë financiar i ndërmjetëm i një njësie ekonomike në përputhje me SNK 34 për pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve duhet të përfshijë rakordimet e përshkruara në paragrafin 24 (a) dhe (b) (plotësuar me të dhënat e kërkuara nga paragrafët 25 dhe 26) ose referencat e kryqëzuara në një tjetër dokument të botuar që përfshin këto rakordime.
- (c) Nëse një njësi ekonomike ndryshon politikat e saj kontabël ose përdorimin e përjashtimeve të tyre që jeten në këtë SNRF, ajo do të shpieqoië ndryshimet në çdo raport financiar të tillë të ndërmjetëm në përputhje me paragrafin 23 dhe do të përditësojë rakordimet e kërkuara nga (a) dhe (b).

Data e hyrjes në fuqi

- 39E Si rezultat i *Përmirësimeve* në SNRF-të e publikuara në Maj 2010 janë shtuar paragrafët 27A, 31B dhe D8B dhe janë ndryshuar paragrafët 27, 32, D1 (c) dhe D8. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon para datës 1 janar 2011, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt. Njësitë ekonomike që kanë adoptuar SNRF-të në periudhat para datës së hyrjes në fuqi të SNRF 1 ose kanë zbatuar SNRF 1 në një periudhë të

PERMIRESIMETË SNRF MAJ

mëparshme janë të lejuara të zbatojnë ndryshimin në paragrafin D8 në mënyrë retrospektive për periudhën e parë vjetore pasi ndryshimi ka hyrë në fuqi. Një njësi ekonomike që zbaton paragrafin D8 në mënyrë retrospektive duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në Shtojcën D të SNRF 1 *Adaptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë*

Paragrafët D1(c) dhe D8 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi D8B.

D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë nga përjashtimet e mëposhtme:

...

(c) koston e supozuar (paragrafët D5–D8A–B);

...

Kosto e supozuar

D8 Një adoptues për herë të parë mund të ketë krijuar një kosto të supozuar në përputhje me PPPK-në e mëparshëm për disa ose të gjitha aktivitetet dhe detyrimet e tij duke i matur ato me vlerën e drejtë në një datë të veçantë për shkak të një ngjarje të tillë si një privatizim apo ofertë publike fillestare. **Ajo**

(a) Nëse data e maties është në ose para datës së kalimit në SNRF-të, njësi ekonomike mund të përdorë matjet e vlerës së drejtë të shkaktuar nga një ngjarje e tillë si kosto të supozuar për SNRF-të në datën e kësaj matjeje.

(b) Nëse data e maties është pas datës së kalimit në SNRF-të, por gjatë periudhës së mbuluar nga pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve, matjet e vlerës së drejtë për shkak të ngjarjes mund të përdoren si kosto e supozuar, kur ngjarja ndodh. Një njësi ekonomike do të njohtë rregullimet që rezultojnë drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara (ose nëse është e përshtatshme, në një tjetër kategori të kapitalit neto) në datën e maties. Në datën e kalimit në SNRF-të, njësi ekonomike do të përcaktojë koston e supozuar duke zbatuar kriteret e paragrafëve D5–D7 ose do të masë aktivitetet dhe detyrimet në përputhje me kërkesat e tjera në këtë SNRF.

D8B Disa njësi ekonomike mbajnë zëra të aktiveve afatgjata materiale ose aktiveve jo-materiale që përdoren, ose janë përdorur më parë, në veprimtaritë që i nënshtrohen rregullimit të tarifës. Vlera kontabël neto e zërave të tillë mund të përfshijë shumat që ishin të vendosura sipas PPPK-ve të mëparshme, por nuk kualifikohen për kapitalizim në përputhje me SNRF-të. Nëse është ky rast, një adoptues për herë të parë, mund të zgjedhë të përdorë si kosto të supozuar vlerën kontabël neto të mëparshme sipas PPPK-së, të një zëri të tillë në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë përjashtim për një zë, ajo nuk duhet ta zbatojë atë në

të gjitha zërat. Në datën e kalimit sipas SNRF-ve, një njësi ekonomike do të testojë për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 secilin zë për të cilin është përdorur ky përjashtim. Për qëllimet e këtij paragrafi, veprimtaritë janë subjekt i rregullimit të tarifës në qoftë se ato ofrojnë mallra apo shërbime për konsumatorët me çmime (d.m.th. tarifa) të përcaktuara nga një organ i autorizuar për të vendosur tarifa që janë detyruese konsumatorët dhe që janë projektuar për të mbuluar kostot specifike që bën njësia ekonomike për të ofruar mallrat ose shërbimet e rregulluara ose dhe për të fituar një kthim të specifikuar. Kthimi i specifikuar mund të jetë një minimum ose varg dhe nuk ka nevojë të jetë një kthim fiks ose i garantuar.

Amendime në SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*

Paragrafi 19, titulli para paragrafit 30 dhe paragrafi 30 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti të fshirë i është vënë viza). Paragrafët 64B, 64C dhe 65A-65E janë shtuar.

Metoda e blerjes

Parimi i matjes

- 19 Për çdo kombinim biznesi, blerësi do të matë në datën e blerjes përbërësit e ndonjë interesave jokontrolluese në njësinë e blerë që përfaqësojnë interesat e pronësisë dhe të drejtën e mbaitësit për një pjesë proporcionale në aktivet neto të njësisë ekonomike në rast likuidimi me ose; në vlerën e drejtë ose në pjesë proporcionale të interesit jokontrollues në aktivet neto të identifikueshme të njësisë së blerë

(a) vlerën e drejtë; ose

(b) pjesën proporcionale të instrumentave të pronësisë aktuale në shumat e njohura të aktiveve neto të identifikueshme të njësisë së blerë.

Të gjithë përbërësit e tjerë të interesave jokontrolluese do të maten me vlerat e drejta në datën e tyre të blerjes, përveç nëse një bazë tjetër matieve është kërkuar nga SNRF-të.

Përjashtime nga parimet e njohjes apo të matjes

Përjashtime nga parimi i matjes

Transaksionet e pagesës çmimet me aksione

- 30 Blerësi do të matë një detyrim ose një instrument kapitali të lidhur me transaksionet e pagesës të bazuar në aksione të njësisë së blerë ose zëvendësimin e transaksioneve të pagesës ~~çmimet~~ me aksione të një njësie të blerë me transaksionet çmimet e pagesës të bazuar në aksione të blerësit në përputhje me metodën në SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione në datën e blerjes*. (Ky SNRF i referohet rezultatit të kësaj metode si “matje e bazuar në treg” të çmimit transaksionit të pagesës të bazuar në aksione.)

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Data e hyrjes në fuqi

- 64B Si rezultat i *Përmirësimeve në SNRF-të* e publikuara në maj 2010 janë ndryshuar paragrafët 19, 30 dhe B56 dhe janë shtuar paragrafët B62A dhe B62B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Zbatimi do të jetë në mënyrë prospektive nga data kur njësia ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF.
- 64C Me *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010 janë shtuar paragrafët 65A-65E. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt. Ndryshimet do të zbatohen në tepricat eventuale që lindin nga kombinimet e biznesit me një datë të blerjes para zbatimit të këtij SNRF, të publikuar në 2008.

Periudha kalimtare

- 65A Tepricat eventuale që rrjedhin nga kombinimet e biznesit datat e të cilave i paraprijnë datës kur një njësi ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF të publikuar në 2008, nuk do të rregullohen në bazë të zbatimit për herë të parë të këtij SNRF-je. Për këto teprica në kontabilitetin e mëposhëm do të zbatohen Paragrafët 65B-65E. Paragrafët 65B-65E nuk do të zbatohen për kontabilizimin e tepricave eventuale që lindin nga kombinimet e biznesit me data të blerjes në ose pas datës kur njësia ekonomike ka zbatuar për herë të parë këtë SNRF publikuar në 2008. Në paragrafët 65B-65E kombinim i biznesit i referohet ekskluzivisht kombinimeve të biznesit, datat e blerjes së të cilave i paraprijnë zbatimit të këtij SNRF të publikuara në 2008.
- 65B Në qoftë se marrëveshja e një kombinimi biznesi parashikon një rregullim në koston e kombinimit i varur nga ngjarjet e ardhshme, blerësi do të përfshijë shumën e këtij rregullimi në koston e kombinimit në datën e blerjes, nëse rregullimi është i mundur dhe mund të matet me besueshmëri.
- 65C Një marrëveshje kombinimi biznesi mund të lejojë rregullime në koston e kombinimit të cilat varen nga një ose më shumë ngjarje në të ardhmen. Për shembull, rregullimi mund të kushtëzohet nga një nivel i caktuar i fitimit të mbajtur ose të arritur në periudhat e ardhshme, apo nga çmimi i tregut i instrumenteve të emetuara që janë duke u mbajtur. Zakonisht është e mundur të vlerësohet shuma e çdo rregullimi të tillë në kohën e kontabilizimit fillestar të kombinimit, pa dëmtuar besueshmërinë e informacionit, edhe pse ekzistojnë disa pasiguri. Në qoftë se ngjarjet nuk do të ndodhin në të ardhmen

apo vlerësimi kërkon të rishikohet, kostoja e kombinimit të biznesit do të rregullohet në përputhje me rrethanat.

- 65D Megjithatë, kur një marrëveshje kombinim biznesi parashikon një rregullim të tillë, atëherë rregullimi nuk përfshihet në koston e kombinimit në kohën e kontabilizimit fillestar të tij nëse ai ose nuk është i mundshëm ose nuk mund të matet me besueshmëri. Në qoftë se më pas rregullimi bëhet i mundshëm dhe mund të matet me besueshmëri, shuma shtesë do të trajtohet si një rregullim në koston e kombinimit.
- 65E Në disa rrethana, blerësi e ka të nevojshme t'i bëjë një pagesë të mëvonshme shitësit, si kompensim për një reduktim në vlerën e aktiveve të dhëna, instrumentave të kapitalit neto të emetuar ose detyrimeve të kryera apo të marra përsipër nga blerësi në këmbim të kontrollit të njësisë së blerë. Ky është rasti, kur për shembull, blerësi garanton çmimin e tregut të kapitalit apo borxhit të emetuar, si pjesë e koston së kombinimit të biznesit dhe është e nevojshme të emetohet kapital shtesë ose instrumente borxhi për të rivendosur koston e përcaktuar fillimisht. Në raste të tilla, nuk njihet rritje në koston e kombinimit të biznesit. Në rastin e instrumentave të kapitalit neto, vlera e drejtë e pagesës shtesë kompensohet me një reduktim të barabartë në vlerën e caktuar të instrumenteve të emetuara fillimisht. Në rastin e instrumenteve të borxhit, pagesa shtesë konsiderohet si një zvogëlim i primit ose një rritje e zbritjes në emetimin fillestar.

Udhëzues për zbatim

Në shtojcën B, paragrafi B56 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti të fshirë i është vënë viza) dhe janë shtuar një shënim në paragrafin B56, një titull pas paragrafit B62 dhe paragrafët B62A dhe B62B.

Përcaktimi se çfarë është pjesë e transaksionit të kombinimit të biznesit (zbatimi i paragrafëve 51 dhe 52)

Pagesa e bazuar në aksione e blerësit në këmbim të shpërblimeve që u takojnë punonjësve të njësisë së blerë (zbatimi i paragrafit 52 (b))

B56 Një blerës mund të këmbëjë shpërblimet¹ në pagesa të bazuara në aksionet e tij (shpërblime zëvendësimi) me shpërblimet që kanë patur punonjësit e njësisë së blerë. Shkëmbimet e opsioneve në aksione apo shpërblimeve të tjera me pagesa të bazuara në aksione në lidhje me një kombinim biznesi trajtohen si ndryshime të shpërblimeve me pagesa të bazuara në aksione në përputhje me SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*. Në qoftë se blerësi është i detyruar zëvendëson shpërblimet e njësisë së blerë, ose të gjitha ose një pjesë të masës të bazuar në tregun e shpërblimeve zëvendësuese të njësisë së blerë do të përfshihen në matjen e shumës së transferuar në kombinimin e biznesit. Paragrafët B57–B62 japin udhëzime se si të caktohet masa e bazuar në treg. Blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë nëse kjo njësi ose punonjësit e saj kanë aftësinë për të zbatuar zëvendësimin. Për shombull, për qëllime të zbatimit të kësaj kërkesë, blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë në qoftë se zëvendësimi është kërkuar nga:

- (a) kushtet e marrëveshjes së blerjes;
- (b) kushtet e shpërblimeve të njësisë së blerë; ose
- (c) ligjet e zbatueshëm ose rregulloret.

Megjithatë, në disa situata, në të cilat shpërblimet e njësisë së blerë mund do të skadonin si pasojë e një kombinimi biznesi dhe, Inë qoftë se blerësi i zëvendëson këto shpërblime kur edhe pse ai nuk është i obliguar

¹ Në paragrafët B56–B62 termi 'shpërblimet e bazuara në aksione' i referohet transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të kushtëzuara ose jo.

ta bëjë këtë, e gjithë masa e bazuar në tregun e këtyre shpërblimeve zëvendësuese duhet të njihet si kosto shpërblimi në pasqyrat financiare pas kombinimit në përputhje me SNRF 2. Kjo do të thotë se masa e bazuar në treg e këtyre shpërblimeve nuk do të përfshihet në matjen e shumës së transferuar në kombinimin e biznesit. Blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë nëse kjo njësi ose punonjësit e saj kanë aftësinë për të zbatuar zëvendësimin. Për shembull, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzuesi, blerësi është i detyruar të zëvendësojë shpërblimet e njësisë së blerë nëse zëvendësimi është kërkuar nga:

- (a) kushtet e marrëveshies së blerjes ;
- (b) kushtet e shpërblimeve të njësisë së blerë; ose
- (c) liqiet e zbatueshme ose rregulloret.

Transaksione pagese me aksione (i shlyer në kapital neto) të njësisë së blerë

- B62A** Njësia e blerë mund të ketë transaksione pagese me aksione të pashlyera që blerësi nuk i shkëmben për transaksionet e tij të pagesës bazuar në aksione. Nëse janë të kushtëzuara, këto transaksione pagese me aksione të njësisë së blerë janë pjesë e interesave jo-kontrolluese në njësinë e blerë dhe maten me masën e tyre të bazuar në treg. Nëse janë të pakushtëzuara, ato maten me masën e tyre të tregut sikur data e blerjes të ishte në datën e dhënies në përputhje me paragrafët 19 dhe 30.
- B62B** Masa e bazuar në treg e transaksioneve të pakushtëzuara të pagesave të bazuara në aksione shpërndahet në interesin jo-kontrollues mbi bazën e raportit të pjesës së periudhës së kushtëzimit të përfunduar kundrejt periudhës më të gjatë të asaj të kushtëzimit total apo periudhës fillestare të kushtëzimit të transaksioneve të pagesës me aksione. Teprica kalohet në shërbimin pas kombinimit.

Shtojca për amendime në SNRF 3 Amendime në SNRF-të e tjera

SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi 44B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 44K.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 44B Hiqet paragrafi 3 (c) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rriedhur nga një kombinim biznesi për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimit të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të fillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).
- 44K Paragrafi 44B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja

Paragrafi 97B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 97G.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 97B Hiqet paragrafi 4 (c) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rriedhur nga një kombinim biznesi për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimit të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të fillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).

- 97G Paragrafi 97B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe matja

Paragrafi 103D është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 103N.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 103D Hiqet paragrafi 2(f) i SNRF 3 (rishikuar në 2008). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNRF 3 (rishikuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet edhe për këtë periudhë të hershme. Megjithatë, ndryshimi nuk ka të bëjë me shumën e kushtëzuar që ka rriedhur nga një kombinim biznesi për të cilin data e blerjes i paraprin zbatimin të SNRF 3 (rishikuar në vitin 2008). Në vend të kësaj, një njësi ekonomike do ta trajtojë një shumë të fillë në përputhje me paragrafët 65A–65E të SNRF 3 (i ndryshuar në vitin 2010).
- 103N Paragrafi 103D u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

Amendime në SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi 32A është shtuar. Paragrafët 34 dhe 36–38 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Paragrafi 44L është shtuar.

Natyra dhe shkalla e rreziqeve që rrjedhin nga instrumentet financiare

32A Sigurimi i informacioneve shpjeguese cilësore në kontekstin e dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore mundëson përdoruesit që duke u nisur nga dhënia e informacioneve shpjeguese përkatëse të formojnë një pamje të përgjithshme të natyrës dhe shkallës së rreziqeve që rrjedhin nga instrumentet financiare. Bashkëveprimi në mes dhënies së informacioneve shpjeguese sasiore dhe cilësore kontribuon për dhënien e informacionit në një mënyrë që u mundëson përdoruesve të vlerësojnë më mirë ekspozimin ndaj rreziqeve të një njësie ekonomike.

Dhënia e informacioneve shpjeguese sasiore

- 34 Për çdo lloj rreziku që vjen nga instrumentat financiare, një njësi ekonomike duhet të paraqesë:
- (a) të dhëna përmbledhëse sasiore lidhur me ekspozimin e saj ndaj rrezikut në fund të periudhës raportuese. Ky informacion shpjegues duhet të bazohet në informacionin e brendshëm për personelin kyç menaxhues të njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura*), për shembull bordin e drejtorëve të njësisë ekonomike ose shefin ekzekutiv.
 - (b) dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 36–42, për aq sa nuk është dhënë në përputhje me (a), përveç nëse rreziku është material (shih paragrafët 29–31 të SNK 1 në lidhje me materialitetin).
 - (c) përqëndrimet e rrezikut nëse nuk dalin qartë nga dhënia e informacioneve shpjeguese e bërë në përputhje me (a) dhe (b).

Rreziku i kredisë

36 Një njësi ekonomike duhet të paraqesë për klasën e instrumentit financiar:

- (a) shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin e saj maksimal ndaj rrezikut të kredisë në fund të periudhës raportuese, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur apo aktiv që mbahet si garanci kredie (p.sh. marrëveshjet për neto që nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNK 32); kjo dhënie e informacioneve shpjeguese nuk kërkohet për instrumentat financiarë vlera kontabël neto e të cilave përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë.;
- (b) ~~në lidhje me shumën që jepet informacion shpjegues në (a), një përshkrim i kolateralit të mbajtur për siguri dhe i aktiveve të tjera të mbajtura si garanci të kredisë dhe efekti i tyre financiar (p.sh. në përcaktim i masës me të cilën kolaterali dhe aktiv tjetër i mbajtur si garanci i kredisë parandalonë rrezikun e kredisë) në lidhje me shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë (nëse është dhënë informacion shpjegues në përputhje me (a) ose është përfaqësuar nga vlera kontabël neto e një instrumenti financiar).~~;
- (c) informacionin në lidhje me cilësinë e kredisë të aktiveve financiare që as nuk ju ka kaluar afati, as janë të zhvlerësuara ; dhe
- (d) ~~[fshirë] vlerën kontabël neto të aktiveve financiare që përndryshe do t'ju kishte kaluar afati apo do ishin të zhvlerësuara, kushtet e të cilave kanë qenë të rinogociuara.~~

Aktivet financiare që ose ju ka kaluar afati ose janë të zhvlerësuara

- 37 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për klasën e aktivit financiar:
- (a) një analizë të moshës së aktiveve financiare që ju ka kaluar afati në fund të periudhës raportuese, por nuk janë të zhvlerësuara; dhe
 - (b) një analizë të aktiveve financiare që janë të përcaktuara individualisht të zhvlerësuara në fund të periudhës raportuese, duke përfshirë edhe faktorët që njësi ekonomike i ka marrë parasysh në përcaktimin se ato janë të zhvlerësuara.; dhe
 - (c) [fshirë] për shumat që jepet informacion shpjegues në (a) dhe (b), një përshkrim i kolateralit të mbajtur nga njësi ekonomike dhe të ndonjë aktivi tjetër të mbajtur si garanci kredie dhe, përveçse kur është praktikisht e mundur, një vlerësim të vlerës së drejtë të tyre.

Kolaterali dhe aktivet e tjera të marra për garanci kredie

- 38 Kur një njësi ekonomike merr aktive financiare ose jo-financiare gjatë periudhës, duke fituar posedimin e kolateralit që mban si garanci ose duke

kërkuar aktive të tjera për garanci (p.sh. garancitë), dhe aktive të tilla plotësojnë kriteret e njohjes në SNRF-të e tjera, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këto aktive të mbaitura në datën e raportimit:

- (a) natyrën dhe vlerën kontabël neto të aktiveve të marra; dhe
- (b) kur aktivet nuk janë lehtësisht të konvertueshëm në mjete monetare, politikat e saj për shitjen e aktiveve të tilla ose për përdorimin e tyre në veprimtaritë e saj.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 44L Nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010 është shtuar paragrafi 32A dhe janë ndryshuar paragrafët 34 dhe 36–38. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*

Para paragrafit 106 është vendosur një titull. Paragrafi 106 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Pas paragrafit 106 është vendosur një titull dhe është shtuar paragrafi 106A. Paragrafi 107 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar). Paragrafi 139F është shtuar.

Struktura dhe përmbajtja

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto

Informacioni që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto

- 106** Një njësi ekonomike duhet të paraqesë një pasqyrë të ndryshimeve në kapitalin neto siç kërkohet nga paragrafi 10. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto përfshin informacionin e mëposhtëm duke treguar në pasqyrë:
- (a) të ardhurat totale të përgjithshme për periudhën, duke treguar veçmas shumat totale që u takon pronarëve të mëmës dhe interesave të pakicës;
 - (b) për çdo përbërës të kapitalit neto, efektet e zbatimit retrospektiv ose riparaqitjen retrospektive të njohur në përputhje me SNK 8, dhe
 - (c) [fshirë]
 - (d) për çdo përbërës të kapitalit neto, një rakordim në mes vlerës kontabël neto në fillim dhe në fund të periudhës, duke dhënë veçmas informacion shpjegues për ndryshimet që rezultojnë nga:
 - (i) fitimi ose humbja;
 - (ii) ~~çdo zë të~~ të ardhurat e tjera të përgjithshme; dhe
 - (iii) transaksionet me pronarët në cilësinë e tyre si pronarë, duke treguar veçmas kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët dhe ndryshimet në interesat e pronësisë në filiale të cilat nuk çojnë në një humbje të kontrollit.

Informacion që paraqitet në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënimet shpjeguese

- 106A** Për çdo përbërës të kapitalit neto një njësi ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënime, një analizë të të ardhurave të tjera të përgjithshme sipas zërit (shih paragrafin 106 (d) (ii)).
- 107** Një njësi ekonomike duhet të paraqesë, ose në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto ose në shënimet shpjeguese, shumat e dividendëve të njohura si shpërndarje për pronarët gjatë periudhës, dhe shumat përkatëse të dividendëve për aksion.

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- 139F** Paragrafët 106 dhe 107 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 106A nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

Kërkesat kalimtare për ndryshimet që rrjedhin si rezultat i SNK 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale

Amendime në SNRF-të

SNK 21 Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit të monedhave të huaja

Paragrafi 60B është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar) dhe është shtuar paragrafi 60D.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 60B SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) shtoi paragrafët 48A-48D dhe paragrafi 49 u ndryshua. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.
- 60D Paragrafi 60B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date.

SNK 28 Investime në pjesëmarrje

Paragrafi 41B është shtuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi 41E.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 41B Në SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) janë ndryshuar paragrafët 18, 19 dhe 35 dhe është shtuar paragrafi 19A. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 35 në mënyrë retrospektive dhe këto ndryshimet në paragrafët 18 dhe 19 dhe në paragrafin 19A në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.

- 41E Paragrafi 41B u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

SNK 31 *Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta*

Paragrafi 58A është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe taktit të fshirë i është vënë viza) dhe është shtuar paragrafi 58D.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 58A Në SNK 27 (i ndryshuar në vitin 2008) janë ndryshuar paragrafët 45 dhe 46 dhe janë shtuar paragrafët 45A dhe 45B. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 46 në mënyrë retrospektive dhe këto ndryshimet në paragrafin 45 dhe paragrafët 45A dhe 45B në mënyrë prospektive, për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2009 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i ndryshuar 2008) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë të hershme.
- 58D Paragrafi 58A u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010 ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në SNK 34 Raportimi financiar i ndërmjetëm

Një titull dhe paragrafi 15 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza). Paragrafët 15A-15C janë shtuar. Paragrafët 16-18 janë fshirë. Një titull dhe paragrafi 16A janë shtuar. Paragrafi 49 është shtuar. Paragrafët 15B dhe 16A ishin më parë paragrafët 17 dhe 16, përkatësisht, si dhe janë dhënë deri në masën për të treguar vetëm ndryshimet nga teksti para-ekzistues.

Përmbajtja e një raporti financiar të ndërmjetëm

Shënimet shpjeguese të zgjedhura Ngjarjet dhe transaksionet e rëndësishme

- 15 ~~Një përdorues i raportit financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike do të ketë gjithashtu të drejtën e qasjes në raportin financiar më të fundit vjetor të kësaj njësie. Prandaj është e nevojshme, që shënimet shpjeguese në një raport financiar të ndërmjetëm të sigurojnë informatat më të reja relativisht të parëndësishme për informacionin që tashmë është raportuar në shënimet e raportit vjetor më të fundit. Në një datë të ndërmjetme, Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në raportin financiar të ndërmjetëm të saj një shpjegim të ngjarjeve dhe transaksioneve që janë të rëndësishme për të kuptuar ndryshimet në pozicionin financiar dhe performancën e njësisë ekonomike që nga fundi i periudhës vjetore raportuese më të fundit është më e dobishme. Informacioni shpiegues në lidhje me këto ngjarje dhe transaksione duhet përditësuar që të japë informacionin përkatës të paraqitur në raportin financiar vjetor më të fundit.~~
- 15A Një përdorues i raportit financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike do të ketë të drejtën e aksesit në raportin financiar vjetor më të fundit të kësaj njësie. Prandaj, është e panevojshme që shënimet shpjeguese në një raport financiar të ndërmjetëm të sigurojnë informatat më të reja relativisht të parëndësishme për informacionin që është raportuar në shënimet shpjeguese të raportit financiar vjetor më të fundit.
- 15B ~~Më poshtë janë dhënë shembuj të llojeve të informacioneve shpjeguese që kërkohen sipas paragrafit 16. SNRF të veçanta japin udhëzime në lidhje me dhënien e informacioneve shpjeguese për shumë nga këta zëra: Më poshtë është një listë e ngjarjeve dhe transaksioneve për të cilat dhënia e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme nëse ato janë të rëndësishme: lista nuk është shteruese.~~
- (a) ulja e vlerës së inventarëve në vlerën neto të realizueshme dhe anulimi i një zhvlerësimi të tillë;

- (b) njohja e një humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve të tjera, dhe anulimi i një humbje të tillë nga zhvlerësimi;
 - (c) anulimi i ndonjë provizioni për kostot e ristrukturimit;
 - (d) blerja dhe shitja e zërave ndërtesa, tokë, makineri dhe pajisje;
 - (e) angazhimet për blerje ndërtesa, tokë, makineri dhe pajisje;
 - (f) zgjidhja e mosmarrëveshjeve gjyqësore;
 - (g) korigjimet e gabimeve të periudhave të mëparshme;
 - (h) [fshirë] ndryshimet në biznes ose në rrethanat ekonomike që ndikojnë në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të njësisë ekonomike, nëse këto aktive ose detyrime janë njohur me vlerën e drejtë apo koston e amortizuar;
 - (i) çdo hua të shtyrë ose shkelje të një marrëveshje kredie që nuk është rregulluar në ose para përfundimit të periudhës raportuese; ~~dhe~~
 - (j) transaksionet me palët e lidhura;
 - (k) transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë të përdorur në matjen e vlerës së drejtë të instrumentave financiare;
 - (l) ndryshimet në klasifikimin e aktiveve financiare si rezultat i një ndryshimi në qëllimin ose përdorimin e këtyre aktiveve; dhe
 - (m) ndryshimet në detyrimet ose aktivet e kushtëzuara.
- 15C SNRF-të individuale japin udhëzime në lidhje me kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese për shumë nga zërat e listuara në paragrafin 15B. Kur një ngjarje ose transaksion është i rëndësishëm për të kuptuar ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë ekonomike ose performancën e saj që nga periudha raportuese vjetore e fundit, raporti financiar i ndërmjetëm i saj duhet të japë një shpjegim dhe një përditësim të informacionit përkatës të përfshirë në pasqyrat financiare të periudhës raportuese vjetore të fundit.

16–18 [Fshirë]

Dhënia e informacioneve shpjeguese të tjera

- 16A **Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese për ngjarjet dhe transaksionet e rëndësishme në përputhje me paragrafët 15–15C,** një njësi ekonomike do të përfshijë informacionin e mëposhtëm, ~~si një minimum,~~ në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të ndërmjetme të saj, ~~qoftë materiale dhe~~ nëse nuk është dhënë informacion shpjegues diku tjetër në raportin financiar të ndërmjetëm. Normalisht informacioni duhet të raportohet në bazë të vitit financiar që

nga fillimi i vitit deri në momentin aktual. ~~Megjithatë, njësia ekonomike duhet të japë gjithashtu informacion shpjegues për ngjarjet ose transaksionet që janë materiale, të nevojshme për kuptimin e periudhës aktuale të ndërmjetme:~~

- (a) një pohim që janë ndjekur të njëjtat politika kontabël dhe metoda të llogaritjes në pasqyrat financiare të ndërmjetme në krahasim me pasqyrat financiare vjetore më të fundit, ose, nëse këto politika, apo metoda kanë ndryshuar, një përshkrim i natyrës dhe efektit të ndryshimit;¹
- (b) komentet shpjeguese në lidhje me sezonalitetin ose periodicitetin të veprimtarive të ndërmjetme;¹
- (c) natyrën dhe shumën e zërave që ndikojnë në aktivet, pasivet, kapitalin neto, të ardhurat neto ose flukset e mjeteve monetare të cilat janë të pazakonta për shkak të natyrës, madhësisë apo ndodhjes së tyre;¹
- (d) natyrën dhe shumën e ndryshimeve në vlerësimet e shumave të raportuara në periudhat e mëparshme të ndërmjetme të vitit aktual financiar ose ndryshimet në vlerësimet e shumave të raportuara në vitet financiare të mëparshme, ~~në qoftë se këto ndryshime kanë një efekt material në periudhën aktuale të ndërmjetme;~~¹
- (e) ~~nxjerrjet,~~ emetimet, riblerjet dhe ripagesat e borxhit dhe të letrave me vlerë të kapitalit;¹
- (f) dividendët e paguar (në total ose për aksion) veç e veç për aksionet e zakonshme dhe aksionet e tjera;¹
- (g) informacionin e mëposhtëm të segmentit (dhënia e informacionit shpjegues të segmentit kërkohet në një raport financiar të ndërmjetëm të një njësie ekonomike vetëm nëse SNRF 8 *Segmentet e shfrytëzimit* kërkon që njësia ekonomike të japë informacion shpjegues për segmentin në pasqyrat financiare vjetore të saj):
 - (i) të ardhurat nga klientët e jashtëm, nëse përfshihen në masën e fitimit ose humbjes së segmentit rishikuar nga shefi operativ i marrjes së vendimeve ose kur rregullisht parashikohet ndryshe nga shefi operativ i marrjes së vendimeve;¹
 - (ii) të ardhurat midis segmenteve, nëse përfshihen në masën e fitimit ose humbjes të segmentit rishikuar nga shefi operativ i marrjes së vendimeve ose kur

- rregullisht parashikohet ndryshe nga shefi operativ i marrjes së vendimeve.⚡
- (iii) një madhësi të fitimit ose humbjes neto të segmentit.⚡
 - (iv) aktivet gjithsej për të cilat ka pasur një ndryshim material nga shuma e paraqitur në pasqyrat financiare vjetore të fundit.⚡
 - (v) një përshkrim të diferencave nga pasqyrat financiare vjetore të fundit në bazë të segmentimit ose në bazë të matjes së fitimit ose humbjes neto të segmentit.⚡
 - (vi) një rakordim të totalit të madhësive të fitimit ose humbjes neto të segmenteve raportuese me fitimin ose humbjen neto të njësisë ekonomike para zbritjes së shpenzimeve tatimore (të ardhurat tatimore) dhe veprimtaritë jo të vijueshme. Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike shpërndan në segmentet raportuese elemente të tilla si shpenzimet tatimore (të ardhurat tatimore), njësi ekonomike mund të rakordojë totalin e madhësive të fitimit ose humbjes neto të segmenteve me fitimin ose humbjen neto pas shpërndarjes së këtyre zërave. Zërat materialë në rakordim duhet të identifikohen veças dhe të përshkruhen në këtë rakordim.⚡
- (h) ~~ngjarjet materiale të mëvoshme deri në fund të pas~~ periudhës së ndërmjetme të cilat nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare për periudhën e ndërmjetme.⚡
 - (i) efektin e ndryshimeve në përbërjen e njësisë ekonomike gjatë periudhës së ndërmjetme, duke përfshirë kombinimet e biznesit, marrjen ose humbjen e kontrollit të filialeve dhe investimeve afatgjata, ristrukturimet, dhe operacionet jo të vijueshme. Në rastin e kombinimeve të biznesit, njësi ekonomike do të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit*.⚡ and
 - (j) ~~ndryshimet në detyrimet ose aktivet e kushtëzuara qysh nga fundi i periudhës raportuese vjetore të fundit.~~

Data e hyrjes në fuqi

49 Nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010, paragrafi 15 u ndryshua, janë shtuar paragrafët 15A-15C dhe 16A, ndërsa paragrafët 16-18

PERMIRRESIME TE SNRF MAJ

janë fshirë. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Amendime në KIRFN 13 Programet e besnikërisë ndaj konsumatorit

Paragrafi 10A është shtuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 10A Paragrafi AG2 u ndryshua nga *Përmirësimet në SNRF-të* të publikuara në maj 2010. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2010 e në vijim. Inkurajohet zbatimi para kësaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin para datës 1 korrik 2010, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shtojcë Udhëzim për zbatim

Paragrafi AG2 ka ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe tekstit të fshirë i është vënë viza).

- AG2 Një njësi ekonomike mund të vlerësojë vlerën e drejtë të krediteve të çmimit duke iu referuar vlerës së drejtë të çmimeve për të cilat ato mund të blihen. Vlera e drejtë e ~~këtyre çmimeve do të zvogëlohet për të marrë krediteve të çmimit merr parasysh, sipas rastit:~~

- (a) ~~shumën e zbritjeve apo të stimujve vlerat e drejta të çmimeve që ndryshe~~ do t'u ofroreshin klientëve të cilët nuk kanë fituar kredite çmimi nga shitja fillestare; dhe
- (b) përqindjen e krediteve të çmimit që nuk pritet të riblihen nga konsumatorët.

Nëse konsumatorët mund të zgjedhin nga një gamë çmimesh të ndryshme, vlera e drejtë e krediteve të çmimit do të pasqyrojë vlerat e drejta të serisë së çmimeve të disponueshme, ponderuar në përpjesëtim me frekuencën me të cilën çdo çmim pritet të jetë zgjedhur.